

# UDHA ISLAMIE

Viti XII - Nr. 6 (136), Qershor, 2014

E përmuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

## RAMAZANI - MUAJI I TË GJITHA MIRËSIVE...







**Imam Muhamed B. Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

*“Muaji i Ramazanit, është ai në të cilin filloi të shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë. Dallues i të vërtetës nga gënjeshtria. E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurrë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë udhëzimin tuaj dhe që të falënderoni.” – Kur’an, El-Bekare, 185*

### **Të nderuar dhe të dashur vëllezër dhe motra besimtarë,**

**E**dhe pak orë na ndajnë nga momenti fatlum i shfaqjes së Hanës së re të Muajit Ramazan, me fillimin e të cilit nis një jetë e re adhurimi dhe kthimi nga Zoti për çdo musliman, që beson në shpresën dhe mundësitë që na jep Zoti, për të rregulluar vit pas viti jetën tonë, sjelljen tonë, marrëdhënien me Madhninë e Tij, veten dhe tjetrin.

Ramazani i sivjetshëm është një hapësirë e re, për t’u dëshmuar besimi dhe vullneti i fesë, në shfaqjen e përkushtimit dhe nënshtrimit ndaj Thirrjes së All-llahut, për t’u dëshmuar ditë pas dite si rrugëtues drejt vlerave islame, me besim dhe bindje!

## **MESAZHI I MYFTIUT NË PRAG TË RAMAZANIT 1435/2014**

Muaji i agjërimet, nuk është një muaj diete, në të cilin privohemi thjeshtë nga ushqimi dhe pija për disa orë në ditë, por ai është një mundësi reflektimi në heshtje mbi detyrimet që kemi si krijesa të Zotit, ndaj dashnisë së Tij, me të cilën është rrethuar jeta e jonë, por që shpesh e harrojmë dhe e neglizhojmë, nga trysnia e jetës materiale dhe hutimi në qoshket e saj.

Ky muaj është mundësia më e mirë për ta kthyer Fjalën e All-llahut, Kur’anin Famëlartë, në jetën tonë. Ai është Fjala e pastër e Zotit të gjithësisë. Ai është Libri, që përmbledh edhe Librat e mëparshëm hyjnorë, duke na ftuar të lexojmë, të besojmë e të respektojmë me nderimin më të thellë, secilin nga të Dërguarit e Tij dhe urtësitë me të cilat që rrethuar jeta e tyre! Kur’ani është Fjala e Zotit, që askush nuk arriti, as mund të arrijë ta devijojë a të ndërhyjë në pastërtinë e tij! Prandaj, le ta shfrytëzojmë këtë muaj, për t’u paqtuar me Kur’anin dhe mesazhet e tij dritësuese për jetën e secilit!

Duke vëzhguar me vëmendje rrjedhën dekadente të jetës shpirtërore dhe morale të botës së sotme, Muaji i Ramazanit na shfaqet si mundësia më e mirë për të kthyer vëmendjen nga feja e argumentuar nga burimi i paprekshëm; Kur’ani, aty ku njeriu mund të gjejë veten e tij dhe të angazhohet për të ndryshuar pozitivisht, që të ndryshojë vetë bota!

### **Vëllezër dhe motra,**

Po na vjen mirësia e Zotit, Ramazani, si një stinë qetësie shpirtërore, për të cilën kemi kaq shumë nevojë, për t’u shkëputur nga rutina

e ditëve të mbushura me zhurmë injorance, afetarizmi, smire, zilie, gënjeshtërash, hilesh, korrupsioni, imoraliteti, humbje kohe, mosrespekti ndaj të drejtës së tjetrit dhe pronës së tij, mosvlerësimi ndaj jetës dhe pasurisë, mosrespektimi i kufijve të hallallit dhe vërsulja e verbër drejt haramëve, që verbojnë zemrën, mendjen, arsytimin, vepërimet! Ja, realitetet shqiptare, që përkthejnë më së miri sot, hutimin dhe verbimin pas materializmit dhe afetarizmit, që kanë për qëllim ta zhveshin individin nga feja dhe morali i saj dhe ta kthejnë në kohërat e injorancës së idhujtarisë.



Prandaj, ju drejtohem ju dhe vetes sime, ta shfrytëzojmë këtë muaj be-gatues, për të ndrequr, atë që është prishur më parë në jetën e secilit dhe veten e tij. Për të kërkuar mëshirë, falje dhe udhëzim nga Zoti, Poseduesi i Vetëm dhe i Vërtetë, mëshirës, i faljes dhe i udhëzimit. Për të shpresuar Dritën e Pëlqimit të Tij për ne, për familjen tonë, për qytetin dhe vendin tonë, për mbarë botën e lodhur nga thirrjet e të mallkuarit dhe shkatërrimi që po bëjnë bijtë e tij!

Ky është muaji, në të cilin ftohem për të rigjetur veten në origjinën e krijimit, në botën e pastër të shpirtit të udhëzuar nga Krijuesi i tij, me një sërë cilësishë dhe vlerash, që i mungojnë botës sonë dhe për të cilat ajo ka më së shumti nevojë!

Po vjen Ramazani, Muaji i shpirtit, i besimit, i adhurimit të pastër dhe i thirrjes drejt vlerave të humanizmit, solidarizimit me njerëzit në nevojë, përkrahjes ndaj të shkelurve e skamnorëve, altruizmit në jetë, pastrimit nga kopracia dhe veset, pasurimit me afrimin e përhershëm drejt Zotit, nëpërmjet rrugëve legjitime që na bëjnë të jemi shembulli i besimtarit, për të cilin Hz. Muhammedi (a.s) thoshte: “Besimtari, prej robëve të Zotit, nuk bëhet i keq e zullumqar ndaj atij që urren, as nuk i hyn në hak atij që do, as nuk e humbet amanetin, as nuk ka mëri, as nuk shan, as nuk mallkon, e pranon të vërtetën edhe po s>ju kërkuar, është i bindur me atë që ka, nuk pretendon atë që s>është e tij dhe nuk e kap kopracia kur është koha për të dhënë”.<sup>1</sup>

Me zemër të mirë Ramazanin, ju, të dashur vëllezër dhe motra besimtarë, Shkodërloces së dashur, Shqipërisë dhe shqiptarëve, kudo që të jenë, mbarë ymetit islam!

*Shkodër, e xhuma,  
më 27 qershor 2014*

1. Hakimi, nga Xhundub Ibni Abdil-lah (r.a).

## RAMAZANI, ALTERNATIVË PËR NDRYSHIM

**T**ë dashur pjesëtarë të komunitetit! Muaji i Ramazanit është muaji i agjërimit dhe muaji i mirësive të panumërta që përjetohen dhe dëshmohen nga miliona myslimanë në mbarë botën. Thelbi i Ramazanit është arritja e devotshmërisë. Allahu (xh.sh.), thotë: **“O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat..”**<sup>1</sup>

Nëse reflektojmë mbi adhurimet e tjera të Islamit, do vërejmë se të gjitha bazohen në të njëjtën esencë, devotshmërinë. Imam Gazaliu, në librin e tij të famshëm *Ihja Ulumud-din*, kur shkruan rreth dimensioneve të brendshme të adhurimeve islame dhe në veçanti të agjërimit, tregon se agjërimi ndahet në tre lloje:

### 1. AGJËRIMI I ZAKONSHËM (SAVM EL- UMUM).

Ky lloj agjërimit praktikohet nga shumë njerëz dhe është thjesht largimi nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime.

### 2. AGJËRIMI I VEÇANTË (SAVM EL-KHUSUS):

Kjo do të thotë: të mbash veshët, sytë, gjuhën, duart, këmbët dhe të gjitha organet tjera larg nga mëkati.

### 3. AGJËRIMI I VEÇANTË NGA TË VEÇANTIT (SAVM KHUSUS EL-KHUSUS):

Kjo do të thotë të agjërosh me zemër ndaj shqetësimeve dhe mendimeve të ndryshme dhe të parëndësishme të kësaj bote, duke shpërfillur në zemër

1. Kuran: (2:183).



**Imam Didmar Faja**  
Arizona - SHBA

çdo gjë përveç Allahut (xh.sh.).<sup>2</sup>

Ai i cili agjëron vetëm duke qëndruar i uritur dhe i etur dhe në të njëjtën kohë nuk e kufizon veten nga epshet, nuk e arrin objektivin e Ramazanit. Kështu që, besimtari duhet të kontrollojë me kujdes gjuhën, sytë dhe veshët e tij.

Tregohet nga Selmani (r.a.), se në ditën e fundit të Shabanit<sup>3</sup>, i Dërguari i Allahut (a.s.), na mbajti një ligjëratë, ku tha: **“O ju njerëz! Një muaj madhështor ju përfshiu juve. Muaji i mirësive. Muaji në të cilin gjendet një natë që është më e vlefshme se një mijë muaj. Allahu agjërimin e tij e bëri obligim, ndërsa, faljen e namazit gjatë netëve të tij e bëri namaz vullnetar (nafileh). Ai, i cili në këtë muaj i afrohet Allahut me një veçori të mire, është njësoj sikur ta ketë kryer një obligim fetar (farz) në muajt e tjerë. Ai, i cili e kryen një obligim fetar, është njësoj sikur t'i ketë kryer shtatëdhjetë obligime fetare në muajt e tjerë. Është muaji i durimit dhe shpërblimi për durimin është Xheneti. Është muaji i solidarizimit. Muaji në të cilin shtohet furnizimi i besimtarit. Kushdo që i jep iftar një agjëruesi, kjo veper do t'i shlyejë mëkatet dhe do t'ia lirojë qafën nga zjarri, si dhe do të ketë shpërblimin e njëjtë me agjëruesin, pa iu pakësuar atij (agjëruesit) asgjë nga shpërblimi i tij. Thanë: “Nuk mundemi të gjithë ne t'u japim iftar agjëruesve. Tha: “Allahu këtë shpërblim ia dhuron**

2. Gazali: *Ihja Ulumud-din*, fq. 426.

3. Muaji i kalendarit Islam.



çdokujt që i dhuron iftar një agjëruesi, goftë edhe një hurmë apo një gllënjë uji, apo qumësht të përzier me ujë. Ai është muaj, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi falje, dhe fundi lirim nga zjarri. Ai i cili ia lehtëson robit të tij, Allahu do t'ia shlyejë mëkatet dhe do ta lirojë nga zjarri. Në këtë muaj shtoni sa më shumë katër veti (të mira), me dy prej të cilave e kënaqni Zotin e juaj, ndërsa, nga dy të tjerat kurrë nuk mundeni të jeni të panevojshëm. Sa i përket dy vetive me të cilat e kënaqni Zotin tuaj, ato janë: Të thënit "Nuk ka Zot përveç Allahut" (la ilahe il-la All-llah) dhe kërkimi i faljes prej Tij. Ndërsa, dy vetitë nga të cilat kurrë nuk mundeni të jeni të pavarur, janë: Të kërkoni prej Allahut Xhenetin dhe të kërkoni prej Tij t'ju mbrojë nga zjarri. Atij që ngop një agjërues, Allahu do t'i japë të pijë nga liqeni (Havd)<sup>4</sup> im një gllënjë, pas së cilës kurrë nuk do ta marrë etja deri sa të hyjë në Xhenet."<sup>5</sup>

Para ardhjes së këtij muaji të shenjtë, besimtari duhet të përgatitet shpirtërisht dhe fizikisht. Nga aspekti spirtual është që ai të largohet nga të keqijat, ta shtojë përmendjen e Zotit dhe nga aspekti fizik duhet që ai ta shtojë faljen e namazit, leximin e Kuranit, të agjërojë disa ditë, sidomos në muajin *Shaban*, që është një muaj para Ramazanit, kështu që kur mbërrin Ramazani, personi mos ta ketë të rëndë agjërimin, faljen e namazeve të Teravis<sup>6</sup> dhe leximin e Kuranit.

Ashtu siç fillojmë të përgatitemi për ardhjen e një miku të shtrenjtë në familjen tonë, i cili do të qëndrojë për një muaj, ashtu duhet dhe më shumë të përgatitemi për ardhjen e muajit të shenjtë të Ramazanit. Nëse besimtari pretendon të përfitojë familjarisht mirësitë, mëshirën dhe faljen e Zotit

(xh.sh.), mobilizimi duhet të shfaqet jo vetëm nga një individ në familje, por nga e gjithë familja.

Muaji i Ramazanit është mundësia më e mirë që besimtari ta përmirësojë veten e tij dhe t'i shfaqë mirësitë ndaj të tjerëve. Thëniet e Pejgamberit (a.s.), na mësojnë se në këtë muaj Allahu (xh.sh.), i lidh djajtë dhe njeriu ballafaqohet kryesisht me armikun e tij të brendshëm, që është vetja e tij (*nefs*). Pra, Zoti ka bërë për besimtarin të arrijë të përmirësohet në këtë



muaj më lehtë se në muajt e tjerë.

Ç'përfiton ai njeri i cili para Ramazanit dhe pas tij mbetet njësoj, pa asnjë ndryshim? Analizoje veten tënde dhe krahasoje nivelin shpirtëror dhe moral para Ramazanit dhe pas tij. Preokupimi yt më i madh gjatë Ramazanit duhet të jetë kualiteti dhe jo kuantiteti. Besimtari duhet të jetë më i preokupuar me mendimin se a do pranohen veprat, sesa me numërimin e veprave që kryen. Tregohet nga Ibn Abbas: "I dërguari i Allahut ishte më

i miri i njerëzve dhe ishte më i mirë nga ç'ishte, në Ramazan..."<sup>7</sup>

Nëse myslimani nuk arrin devotshmërinë në këtë muaj, kur mund ta arrijë atë vallë? Shokët e Profetit (a.s.), luteshin muaj të tërë pasi që kalonte Ramazani që Allahu t'ua pranonte dhe gjithashtu luteshin dhe përgatiteshin përpara shpirtërisht dhe fizikisht që ta mbërrinin atë. Kjo tregon rëndësinë dhe dëshirën për përmirësim, që ata tregonin gjatë këtij muaji të bekuar.

Për të theksur thelbin e agjërimin dhe për t'u treguar njerëzve se Ramazani nuk ka për qëllim vetëm që besimtarët të qëndrojnë pa ngrënë dhe pa pirë, Profeti Muhamed (a.s.), shprehet: "Nëse një person nuk braktis të folurim keq (ku përfshihen rrenat, fjalët e pista, marrja nëpër gojë etj.) dhe sjelljen e keqe gjatë agjërimin, atëherë Allahut nuk i duhet e qëndruara jote pa ngrënë dhe pa pirë..."<sup>8</sup>

Në librin *Ihja Ulumud-din*, të Imam Gazaliut, gjithashtu tregohet një thënie nga Ebu Darda, shokut të Profetit (a.s.), i cili bën një krahasim të çuditshëm, por real dhe domethënës midis atyre që agjërojnë duke kuptuar domethënien e agjërimin dhe atyre që agjërojnë pa e kuptuar qëllimin: "Sa i mirë është gjumi dhe mosagjërimi i të diturve!" A nuk e vendos poshtë ngritjen nga gjumi dhe agjërimin e mëndjelehtëve?"<sup>9</sup>

Gjatë këtij muaji myslimanët inkurajohen të jenë më bujarë, duke ushqyer të varfrit dhe duke ndihmuar ata që kanë nevojë. Në një hadith tjetër, Pejgamberi ynë i dashur Muhamedi (a.s.), ka thënë: "**Ai që ushqen një person tjetër me Iftar, fiton shpërblimet e njëjta si ai që agjëron, pa ia zvogëluar**

4. Liqen në botën tjetër.

5. Muhammed Ibn Khuzejmeh: *Sahih ibn Khuzejmeh*, El-Mektebeh el-Islamij, Bejrut, 1970, v.3, Hadithi 1887.

6. Falja gjatë netëve të muajit Ramazan.

7. Bukhari: *Kitab el-Savm*, v. 9, Hadithi 1783.

8. Ibid. Hadithi 1784.

9. Gazali: *Ihja Ulumud-din*, fq. 430.

**shpërblimet agjëruesit.**<sup>10</sup>

Përmbushja e adhurimeve me sinqeritet dhe devotshmëri gjatë këtij muaji, rezulton në pastrimin e zemrës dhe sjell mëshirën dhe faljen e Allahut (xh.sh.). Tregohet se Profeti (a.s.), u shpreh: “Kushdo që agjëron Ramazanin me besim të sinqertë dhe shpreson të fitojë shpërblimet e Zotit, atij i falen të gjitha gabimet.”<sup>11</sup>

Të nderuar besimtarë! Agjërimi i muajit të Ramazanit, përveçse është një akt adhurimi dhe kurs trajnimi i karaktereve tona, është gjithashtu dhe një formë përvetësuese e shprehjes së mirënjohjes ndaj Allahut (xh.sh.). Kur njeriu mbetet pa bukë dhe pa ujë, ai shumë mirë e kupton rëndësinë e tyre dhe është më shumë mirënjohës. Siç thotë populli: “Kur të mungon diçka, atëherë ia di kimetin (vlerën) asaj.”

**RAMAZANI****ËSHTË MUAJI I KURANIT**

Fjala e Zotit, Kurani, ka filluar t'i zbritet të dërguarit Muhamed (a.s.), gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit dhe ishin po ato pesë versetet e para të sures “Ale” që filluan t'i zbrisnin Muhamedit (a.s.), përmes engjëllit Xhebrail. Në Kuran thuhet: **“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja)...”**<sup>12</sup>

Engjëlli Xhebrail ia zbriti Kuranin Muhamedit (a.s.), në Natën e Kadrit. Kjo natë, për veçoritë e saj, është më e çmueshme se një mijë muaj. 102 Muhamedi (a.s.), nuk ua tregoi besimtarëve saktësisht se kur është ajo natë, por i këshilloi ata ta kërkojnë në dhjetë netët e fundit të Ramazanit, në ato teke. Shumë nga shokët e tij të

moshuar kishin bindje se ajo është e njëzeteshtata natë e Ramazanit.

Përmes vargjeve kuranore dhe traditës profetike, ne jemi të inkurajuar ta lexojmë Kuranin e shenjtë shpesh, sidomos gjatë muajit të Ramazanit, ndërkohë që shpërblimet e leximit rriten. Vajza e dashur e Profetit (a.s.), Fatime (r.a.), thekson se babai i saj e lexonte të gjithë Kuranin një herë gjatë muajit të Ramazanit me engjëllin Xhebrail, përveç Ramazanit të fundit, gjatë të cilit ai e lexoi atë dy herë.<sup>13</sup>



Për këtë arsye, leximi i tij një herë gjatë këtij muaji është i inkurajuar. Caktoji vetes tënde që këtë Ramazan ta përfundosh leximin e Kuranit dhe të zbatosh mësimet e tij në jetën tënde të përditshme. Kur është pyetur gruaja e Profetit (a.s.), se si ishte morali i atij zotërie, ajo ju përgjigj: “Moral i tij ishte Kurani”<sup>14</sup>

**KUSH NUK E KA OBLIGIM AGJËRIMIN E RAMAZANIT?**

- Një jomusliman
- Udhëtari
- I sëmuri
- Fëmija që nuk ka arritur moshën e pubertetit
- Njerëzit e papërgjegjshëm
- Njerëzit të cilët janë të vjetër dhe nuk mund të agjërojnë, për shkak të dobësisë së tyre
- Një femër gjatë menstruacioneve të saj ose dhe në periudhën e paslindjes

- Personi *Murted*<sup>15</sup>

Udhëtarët, të sëmurët e përkohshëm, gruaja që është në menstruacione ose periudhën pas lindjes, duhet t'i zëvendësojnë ato ditë të humbura pas Ramazanit. Ata që janë të sëmurë kronikë, duhet të japin Fidje (të ushqyerit e një të varfri në Syfyr dhe Iftar gjatë gjithë Ramazanit ose të ushqyerit e tridhjetë personave Syfyr dhe Iftar për një ditë vetëm gjatë Ramazanit)

**LISTA E RAMAZANIT**

- Kufizojë veten në ngrënie dhe pije.
- Dhuro shpesh shuma të vogla të bamirësie.
- Qëndro në kontakt të përditshëm me leximin e Kuranit dhe mundohu të mësosh ajete të reja.
- Merr pjesë në faljen e namazit të *Teravisë*.
- Shkëputu nga thashethemet, gënjeshttrat, dhe fjalët e këqija.
- Ruaji lidhjet me të afërmit dhe miqtë tuaj.
- Qëndro në dietë teknologjije (duke zvogëluar përdorimin e televizorit, kompjuterit, etj.)
- Shto aktivitetet shpirtërore.
- Bëhu i mëshirshëm dhe falës dhe mundohu t'i mbash larg dhe të tjerët nga rruga e gabuar.

10. Tirmidhi: *Kitab el-Savm*, Hadithi 807.

11. Ibid. Hadithi 808.

12. Kuran: (2:185).

13. Shiko: Bukhari: *Kitab Fadail el-Kuran*, v.19, Hadithi 4676.

14. Bukhari: *Book of Muslim's moral and manners*, fq.139.

15. Person që ka braktisur fenë islame.





Lavdrim Hamja, teolog

**T**ë gjitha ditët, muajt dhe krejt koha janë të Allahut, por vet Ai (xh.sh) i ka dalluar disa ditë dhe muaj. Dhe, ndër këto dallime, e do të thosha më i miri i tyre është pa dyshim muaji i bekuar i Ramazanit.

E nëse në këtë botë ekziston diçka e mirë dhe me vlerë të madhe, e cila nuk mund të përshkruhet me fjalë, ajo pa dyshim që është muaji i Ramazanit. Sepse, sado që të flasim për mirësitë, begatitë, mëshirën, vlerën, dobitë etj., që ka ky muaj, si në këtë botë, por veçanërisht në botën tjetër, kurrë nuk do të mund t'i përfundojmë. Nga cilado anë, ose drejtim të fillosh të flasësh për agjërimin e muajit të Ramazanit, ai është i mbushur me plot mirësi dhe begati.

Me të vërtetë, nuk gjej fjalë më të mirë për ta përshkruar këtë mirësi se sa ky hadith i të dashurit tonë, Pejgamberit (a.s) i cili ka thënë: "Agjërimi është i Allahut (a.xh) dhe askush nuk e di shpërblimin e agjëruarit, përveç Allahu (a.xh)." (Tabarani - *I saktë me transmetime të tjera*).

Pejgamberi (a.s) ka thënë: Allahu (xh.sh) thotë: "Çdo punë e birit të Ademit është e tija, përveç agjërimin, ai është i Imi dhe Unë e shpërblej për të..." (Buhariu dhe Muslimi)

Nuk ka nderë dhe vlerësim më të madh për punëtorin, se sa të punojë një punë dhe atë ta marrë Allahu i Lartë për Vetën e Tij dhe kjo punë është agjërimi.

"O ju që keni besuar, agjërimi ju

## RAMAZANI MUAJI I TË GJITHA MIRËSIVE...

është bërë obligim, siç ka qenë obligim edhe për ata që kanë qenë përpara jush, në mënyrë që të bëheni të devotshëm." (Bekare: 183)

Ramazani është muaji i mëshirës, muaji i faljes së gabimeve, muaji i pranimit të lutjeve, muaji i shumëfishimit të shpërblimeve, muaji i shërrimit prej sëmundjeve trupore dhe shpirtërore, muaji i shpëtimit dhe i mirësive. Prandaj duhet shfrytëzuar ky muaj me vepra të mira, me agjërim, me falje, me lexim Kur'ani, me sadaka, me lutje, me harmoni dhe falje për njeri-tjetrin, përpara se ai të shkojë.

Vini re se si i dashuri ynë, Pejgamberi (a.s) e përshkruan muajin e Ramazanit: "Ju erdhi Ramazani muaji i begatitë të Allahut në të cilin zbrit mëshira, fshihen gjynahet dhe pranohen lutjet. Allahu ju vështron duke bërë gara me njeri-tjetrin në adhurime dhe mburret me ju te engjëjt e Tij, prandaj shpalosni prej vetes suaj vepra të mira, sepse i humbur dhe i dëshpëruar është ai njeri, i cili privohet nga mëshira e Allahut në këtë muaj." (Tabarani)

Me të vërtetë i humbur dhe i dëshpëruar është ai njeri, i cili brenda këtij muaji të bekuar nuk fiton mëshirë, falje dhe shpëtim.

Allahu e ka mbushur me të gjitha të mirat këtë muaj. Që nga nata e parë e teravisë, ende pa filluar nga agjërimi Zoti i Madhëruar i ka hapur dyert e mirësive të Tij për ata, të cilët kanë vendosur të përkushtohen gjatë muajit të Ramazanit. Shikoni se çfarë ka dhënë Allahu i Madhëruar, për ymetin e Muhammedit (a.s) në muajin e Ramazanit:

Xhabiri (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "I janë dhënë ymetit tim pesë gjëra në Ramazan, të cilat

nuk u janë dhënë asnjë pejgamberi përpara meje:

E para: Në natën e parë të Ramazanit, Allahu e shikon ymetin tim dhe atë që Allahu e shikon nuk e dënon kurrë.

E dyta: Shija e gojës së agjëruarit në mbrëmje është më e mirë tek Allahu se sa era e miskut.

E treta: Engjëjt kërkojnë falje për ta çdo ditë e natë.

E katërta: Allahu (xh.sh) urdhëron xhenetin e Tij duke i thënë: Përgatitu dhe zbukurohu për robërit e Mi. Pothuajse janë afruar të pushojnë prej lodhjeve të dynjasë për në strehën dhe në xhenetin Tim.

E pesta: Në natën e fundit, Ai i ka falur të gjithë.

Një njeri e pyeti: Ajo natë është nata e Kadrit? Pejgamberi (a.s) tha: Jo, a nuk i ke parë punëtorët, të cilët punojnë dhe kur e përfundojnë punën, atëherë e marrin shpërblimin." (Bejhakui, Imam Ahmedi dhe Bezari)

Si mundet njeriu i mençur të largohet prej gjithë këtyre mirësive dhe me të vërtetë, te cili popull tjetër mund të gjenden këto mirësi, përveç në ymetin e Pejgamberit tonë (a.s).

Prandaj, të mos i humbasim këto shanse, sepse nuk dihet se sa gjatë do të jetojë secili nga ne. Askush nga ne nuk e di dhe nuk e ka të garantuar se a do ta mbërrijë Ramazanin tjetër, madje asnjëri nga ne nuk e ka të sigurt se a do të jetojë të nesërmen për ta agjëruar. Kështu që, agjërimi është detyrë për çdo mysliman, jo se Zoti (xh.sh) ka nevojë për agjërimin tonë, por ne kemi nevojë për të dhe vetëm ne përfitojmë nga kjo detyrë.

Agjërim me besim, i bindur dhe i

vendosur për këtë adhurim që është duke u kryer, në fund të tij, agjëruesi pastrohet prej të gjitha gabimeve. Ebu Hurejra (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Allahu i Lartësuar ju ka bërë obligim agjërimin e Ramazanit, ndërsa unë ju kam bërë synet namazin e tij (teravinë). Kështu që, kush e agjëron Ramazanin dhe falë teravinë, me besim, me bindje dhe vendosmëri, ai njeri del nga Ramazani i pastër nga gabimet, si ditën që e ka lindur nëna e tij." (Nesaiu)

Po, sa gabime kemi bërë dhe bëjmë çdo ditë! Sa herë ndoshta e kemi hidhëruar Zotin tonë, me gjuhët tona, me shikimet tona, me dëgjimet tona, me veprat tona! Sa herë i kemi thyer urdhrat e Zotit dhe sa detyra ndoshta na kanë ikur pa i mbaruar? Me çfarë tjetër mund t'i fshijmë dhe t'i pastrojmë këto gabime, përveç se me agjërim?!

Allahu i Madhëruar kërkon prej robërve të Tij të sakrifikojnë në jetën e kësaj bote për një jetë më të mirë, qoftë në këtë botë, por edhe në botën tjetër. Të sakrifikosh për hir të Zotit nuk do të thotë vetëm të vdesësh në rrugën e Tij, ashtu siç mendojnë disa njerëz, ndoshta kjo është sakrificë më e lehtë, por të jetosh në rrugën e Tij.

Një dijetar bashkëkohor islam ka thënë: "Nuk më mahnit fakti që disa njerëz thonë dua të vdes në rrugë të Zotit, por më mahnit fakti se përse njerëzit nuk thonë dua të jetoj në rrugë të Zotit."

Kjo është më se e vërtetë dhe sot kërkohet, veçanërisht brenda muajit të Ramazanit që myslimani të jetojë në rrugën e Zotit brenda këtij muaji. Muaji i Ramazanit tregon se myslimani dëshiron të jetojë në rrugën e Zotit, apo nuk dëshiron të jetojë në rrugën e Tij.

Secili nga ne le të praktikojë për një muaj me rrallë një jetë besimtare, duke kryer plotësisht detyrat ndaj Zotit, duke duruar jo vetëm



urinë dhe etjen, por edhe të folurit, zemërimin, shikimin, dëgjimin etj, me qëllim që pas Ramazanit ta ketë më të lehtë vazhdimin e të jetuarit në rrugën e Zotit. Ky është edhe qëllimi i agjërimin, të cilin Allahu na e ka bërë obligim: "Në mënyrë që të bëheni të devotshëm", pra të disiplinohemi nga të gjitha drejtimet.

Edhe Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush nuk lë fjalët dhe veprat e këqija, Allahu nuk ka nevojë për atë njeri që të lërë ushqimin dhe pijen e tij." (Buhariu)

Përpara se të njihemi edhe me disa hadithe të Pejgamberit (a.s) për mirësinë dhe shpërblimin që ka agjërimi i Ramazanit, le të pyesim veten tonë: Si jemi duke agjëruar deri tani? Vetëm nga ushqimi dhe pija, për të cilin Zoti nuk ka nevojë për ne që të rrimë pa ngrënë dhe pa pirë, apo jemi duke agjëruar me gjithë qenien tonë, me të gjitha gjymtyrët dhe me të gjitha shqisat. Në qoftë se jemi duke agjëruar me trup dhe me shpirt, atëherë le të gëzohemi me këto thënie të të dashurit tonë, Muhammedit (a.s) i cili thotë:

"Kush e agjëron Ramazanin me besim, bindje dhe vendosmëri, atij i falen të gjitha gjynahet e kaluara." (Buhariu dhe Muslimi)

"Në xhenet është një derë, e cila quhet Rejjan, përmes saj hynë agjëruesit në Ditën e Kiametit. Askush

tjetër nuk hyn, përveç tyre. Thuhet: Ku janë agjëruesit? Ngrihen në këmbë, hynë nga ajo derë, pastaj ajo mbyllet." (Buhariu)

"Tre lloj njerëzish nuk ju kthehen prapësht lutjet e tyre, ndër to, agjëruesi duke bërë iftar." (Tirmidhiu)

"Sikur një njeri të ketë agjëruar një ditë nafle, vullnetare, pastaj t'i jepet toka e mbushur me flori, nuk e ka marr shpërblimin që meriton, përveç se në Ditën e Llogarisë." (Ebu Jeala dhe Tabarani)

Në fund, të mos harrojmë se çdo vepër të mirë që punojmë brenda muajit të Ramazanit ajo shpërblehet shumë herë më tepër se sa jashtë Ramazanit, prandaj le t'i shtojmë sa më shumë veprat e mira. Dhe ndër këto vepra të mira, patjetër që është edhe zekati, prandaj të mos ngurrojmë të japim prej asaj që Zoti na ka dhënë, sepse do të shpërblehemi për ta dhe mirësia dhe begatia e saj kurrë nuk ka për të mbaruar, sa të jemi gjallë në këtë botë, por edhe pas vdekjes. Ajo që japim për hir të Zotit, ajo gjë ka për të na i zbardhur fytyrat tona atë ditë kur do të dalim për të dhënë llogari. Të japim pra zeqat dhe sadaka, Zoti na e shtoftë pasurinë, mirësinë dhe begatinë e Tij dhe na shpërbleftë me të mira në dynja dhe në ahiret.

Amin!..





**Idmir Plaku**

imam, xhamia "Ebu Bekër"

**N**ë vlerën e agjërimit një rëndësi të veçantë ka edhe reflektimi i gjymtyrëve gjatë praktikimit të tij. Allahu (xh.sh.) na ka njoftuar se çdo gjymtyrë e trupit ka përgjegjësi për atë që vepron. Allahu (xh.sh.) thotë: "Me të vërtetë të dëgjuarit, të parët, dhe zemra për të gjitha këto ka përgjegjësi."<sup>1</sup>

Agjërimi është një disiplinë shumë e mirë që synon ruajtjen e kësaj përgjegjësie të besimtarët. Të agjërosh do të thotë të jesh në gjendje të mbash përgjegjësi të harmonizuar mes gjymtyrëve të trupit. Agjërimi nuk është thjesht ndalesë nga ushqimi e pija apo marrëdhëniet intime gjatë një harku kohor të caktuar. Vërtetë që këto ruajnë vlerën e tij, por ajo që përcakton shkallën e kësaj vlere është sjellja e gjymtyrëve.

Kur njeriu agjëron atëherë ai ka veshur parzmoren e moralit që e ruan nga sjellja e keqe. Transmetohet se i Dërguari (a.s.) ka thënë: "Agjërimi është mburojë, derisa nuk shpohet." Dikush e ka pyetur: Me çfarë shpohet?" Është përgjigjur: Me gënjeshtër ose me përgojim".<sup>2</sup> Ashtu si çdo adhurim edhe agjërimi ka shpirtin e vet. Kjo forcë shpirtërore që buron nga zemra pasqyrohet në çdo gjymtyrë të

1. El-Isra,36

2. Nesaiu, Hakimi sipas kushtit të vënë nga Buhariu.

## RËNDËSIA E AGJËRIMIT TË GJYMTYRËVE

trupit. Syri shikon, gjuha përkthen, dora vepron, këmbët ecin sipas asaj që ndjen e i thotë mendja e zemra. Çdo gjymtyrë e trupit ka busull orientimi mendjen e zemrën.

Prandaj i Dërguari (a.s.) ka vendosur kusht, për të agjëruar muajin e Ramazanit sipas kësaj busulle (me besim dhe bindje) si garanci për t'iu falur të gjitha mëkatet.

I Dërguari (a.s.) ka thënë: "Kush

dallues i besimtarit. Në lidhje me këtë Allahu (xh.sh.) thotë: "Dhe kur dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, ata i kthejnë shpinën".<sup>4</sup> Ndërsa transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Ai që rri duke dëgjuar është një prej përgojuesve".<sup>5</sup> Po kështu syri duhet të përjetojë agjërimin duke e ruajtur nga harami dhe pjesët intime të trupit.

Allahu (xh.sh.) thotë: "Thuaju be-



agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe bindje, i falen të gjitha mëkatet e tij"<sup>3</sup>

Nëse njeriu dëshiron t'i arrijë vlerën dhe shpërblimet e agjërimit të muajit të Ramazanit, çdo gjymtyrë duhet ta përjetojë agjërimin. Veshi të përjetojë agjërimin duke e ruajtur nga çdo bisedë e pahijshme e imorale. Kjo gjë është tipar

3. Buhariu.

simtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta... Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre".<sup>6</sup>

4. El-Kasas, 55.

5. Ibn Asakir në "Tarih". Imam Subki thotë se nuk ia ka gjetur zinxhirin, por dijetarët bien dakort se kuptimi është i vërtetë.

6. En-Nur, 30-31.



Në ditët e sotme nuk është e lehtë që ta ruash syrin nga moda e lakuriqësisë të tejskajshme e kudo gjendur. Por besimtari me forcën e besimit dhe pastërtinë e agjërimit duhet që ta sfidojë këtë model që i ofrohet, e padyshim që edhe shpërblimi tek Allahu do të jetë më i madh. Ruajtja e gjuhës nga përgojimi, mbartja e fjalëve, dëshmia e rreme, gënjeshtret e bisedat e kota, ka një rëndësi të madhe në vlerën e agjërimit. Në shumë hadithe i Dërguari (a.s.) vlefshmërinë e agjërimit e ka lidhur me këtë organ të trupit.

Nëse agjërimi nuk vë nën kontroll gjuhën, atëherë vlera e tij është thjesht uria dhe etja gjë për të cilën Allahu nuk ka nevojë. Kjo për faktin se agjërimi i shoqëruar me gjet, mbartje fjalësh është i pakuptimtë. Agjërimi të shpie në xhenet ndërsa gjeteti e mbartja e fjalëve në xehenem. Kjo kuptohet nga hadithet profetike të cilat nuk kanë kundërtënie por përkundrazi çdo thënie përforcon njëra tjetrën.

I Dërguari (a.s.) ka thënë: "Nuk hyn në xhenet mbartësi i fjalëve."<sup>7</sup> Ndërsa në një hadith tjetër thotë: "Disa agjërues nga agjërimi i tyre kanë vetëm urinë kurse disa falës të namazit të natës vetëm pagjumësinë".<sup>8</sup> Po kështu i Dërguari i Allahut thotë: "Kush më garanton ç'ka midis nofullave dhe midis këmbëve të tij, do t'i garantoj xhenetin".<sup>9</sup> Ashtu siç ruajmë gjuhën duhet të tregojmë kujdes edhe në ruajtjen e duarve. Ruajtja e tyre nga e keqja, si vjedhja apo dëmtimi i krijesave, është prej shenjave të muslimanit të mirë.

I Dërguari (a.s.) ka thënë: "Musliman i mirë është ai që muslimanët e tjerë janë sigurt prej gjuhës dhe

duarve të tij."<sup>10</sup> Duke qenë të kujdesshëm ndaj fjalëve që flasim padyshim që kjo disiplinë bën efektin e saj edhe në duar e këmbë. Duke agjëruar çdo gjymtyrë pastrohet nga mëkatet, mësohet me pastërtinë, disiplinën, vetëkontrollin dhe amanetin. Në të vërtetë ky është edhe qëllimi i agjërimit të gjymtyrëve.

Çdo gjymtyrë i rikthehet natyrshmërisë së pastër të krijimit, në mirësi dhe larg mëkateve. Allahu (xh.sh.) këto gjymtyrë i ka krijuar duke ia lënë amanet njeriut në trupin e tij. Ruajtja e gjymtyrëve nga gjynahet duke i pastruar me ujin e ibadetit është mirënjohje ndaj Allahut për mirësinë e tyre. Kush tregohet mirënjohës ndaj Allahut për mirësitë e tij shpërblimi për të është i sigurt.

Me të hyrë ky muaj shumë gjëra natyrshëm fillojnë të ndryshojnë për së mbari. Ndryshojnë sepse ndryshon vetë sjellja e njeriut qoftë në familje apo shoqëri. Çdo veprim i besimtarit është në skanerin e agjërimit të tij. Kur njeriu është i vetëdijshëm se çdo gjë monitorohet edhe përgjegjësia e tij rritet më shumë.

Në sajë të kësaj ndjeshmërie të madhe atmosfera që të afron ky muaj është e papërshtueshme. Kur gjymtyrët i nënshtrohen edukatës së agjërimit, sjellja e njeriut programohet sipas shpirtit të adhurimit. Familjes i bashkëngjitet harmonia, ngrohtësia e iftarit dhe syfyrit, punës i afrohet ibadeti, shoqërisë xhemati e xhamia. Kjo është ajo çfarë Allahu kërkon nga besimtarët gjatë adhurimit të Tij. Së fundmi, e lusim Allahun që iftari i gjuhës sonë të jetë fjala e mirë, dëgjimi e shikimi në të lejuarën. Të na forcojë besimin për ta përjetuar sa më mirë këtë muaj të madhnueshëm.

10. Muttefik alejhi.

7. Muttefik alejhi.

8. Ibn Maxheh dhe Nesaiu.

9. Buhari.







## “ALL-LLAHU EKBER ZBUKURUAN KALAJA

**D**itën e shtunë, më 14 qershor 2014, sektori i arsimit në Myftininë Shkodër, kishte planifikuar zhvillimin e aktivitetit: “Një dite argëtuese në krahët e xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut”, me fëmijët e kurseve fetare të xhamive të Myftinisë Shkodër.

Që herët, imamët e xhamive dhe fëmijët e kurseve përkatëse, u tubuan para xhamisë së Parrucës dhe nën drejtimin e teologut Arben Halluni, u drejtuan nga kalaja e Shkodrës, për të kaluar ca orë të këndshme, në shoqëri të lojrave të ndryshme, konkurseve, bisedave fetare dhe namazeve nafle, në hapësirat e rrënojave të xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut.

Për të përshëndetur fëmijët dhe imamët e pranishëm, mbërriti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili shprehu gëzimin e tij për këtë organizim të goditur të sektorit të arsimit, në shërbim të gjallërimit të jetës fetare të fëmijëve frekuentues të xhamive të shumta të Shkodrës.



# R” DHE SALAVATET ANË E SHKODRËS...

Në fjalën e tij para të pranishëmve, Myftiu ka kërkuar nga fëmijët që mos ta harrojnë këtë ditë të mbushur me mirësi vëllazërie islame, nën përkujdesjen e imamëve të dashur.

“Dua nga ju që të vështroni me vëmendje objektin pas shpinës tuaj. Është xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut. Xhamia e jonë, xhamia e juaj! Mos e harroni këtë pamje, thujuani edhe shokëve tuaj se ishim në kala, në oborrin e xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut. Dhe lutuni që në një ditë të afërt, të faleni e të luteni në këtë xhami, tamam si paraardhësit tuaj, muslimanët e hershëm të Shkodrës!”- ka thënë Myftiu.

Më pas, Myftiu ka kërkuar nga të pranishmit që ta madhërojnë All-llahun me tekbiere, të cilat janë përsëritur disa herë, duke krijuar emocione dhe kënaqësi në mesin e pjesëmarrësve në këtë aktivitet të bukur. Tubimi dhe aktiviteti është mbyllur, teksa nën drejtimin e Myftiut, të gjithë këndonin salavate mbi të Dërguarin e All-llahut, Hz. Muhammedin (a.s).







Hfz. Mehas Alija

Imam në xhaminë "El-Hidaje", Zvicër

**“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”** (El-Bekare, 183)

Të jesh musliman do të thotë të jesh në kënaqësi të shumta, në radhë të parë duke qenë rob i denjë i Allahut, për shkak se ta kesh Allahun në anën tende, do të thotë, gjithashtu, të jesh njeriu më i pasur dhe më i pushtetshëm në botë. Sipas një hadithi kudsî, thotë Muhammedi a.s. se Allahu i Madhërishtëm ka thënë: *“O rob i im! Më kërkoi Mua që të më gjeshe. Nëse më gjenë Mua, dije se ke gjetur gjithçka. E nëse më humbë Mua, dije se ke humbur gjithçka.”*

Pastaj, kënaqësi tjetër e këtyre ditëve është ndjesia jonë që ka krijuar pritja e Muajit të shenjtë të Ramazanit. Ja, kanë ngelë edhe ca ditë që të vijë midis nesh muaji më i bekuar, muaji i Kur’anit, muaji i Udhëzimit dhe i zhvillimit shpirtëror, muaji i revizionit tonë.

Ardhja e tij vetëm se ka filluar të nuhatet, e ne, ndonëse për njëmbëdhjetë muaj rreshtë, të preokupuar me kënaqësitë e kësaj bote, kemi harruar ta mbushim shpirtin me aromën e adhurimit që ofron sofrat e Allahut në Ramazan.

Të nderuar vëllezër e motra, Ramazani vjen për të na pastruar dhe forcuar. Ai vjen, gjithashtu, për të na mësuar se të shesësh të ardhëshmen me

## MIRË SE VJEN, O HËNË E RAMAZANIT...

të tashmen, dhe t’ia kthesh shpinën botës së amshueshme, duke u marrë vetëm me atë që është kalimtare, nuk është mençuri, por budallallëk.

Me rastin e kësaj hutbeje, do të doja që pjesën vijuese ta përmbledh me një prononcim të dijetarit të shquar Abdullah Drazit, i cili, duke biseduar me Hënë e Ramazanit, shprehet: *“Eja, o Hënë e re e Ramazanit, eja dhe, për besimtarët, le të jetë ardhja jote mëshirë, përparim dhe vëllazërim. Eja, e sillu njerëzve argumentin e së vërtetës, në vend të argumentit të forcës, e vendos ligjin e pajtimit dhe të butësisë, në vend të ligjit të brutalitetit dhe dhunës. Eja dhe mbushë tokën me shkëlqim dhe paqe, pasi që është kapluar nga padrejtësia, dhuna dhe*



*errësira. O hënë e re e Ramazanit, me dritën tënde dritëso tërë botën muslimane, dhe tek bijtë e saj lësho shkëndijat e frymëzimit me të cilat do të udhëhiqet në çdo vend dhe në secilin moment. Hënë e bekuar e Ramazanit, hyr në shtëpitë e Allahut dhe mbushi ato plotë nur e dritë, kurse dyert e tyre mbaji të hapura ditën dhe natën, ashtu që, në asnjë moment, të mos ngelin të boshatisura, pa namazlinj, pas lexues të Kur’anit, pa udhëzues dhe pa to që kërkojnë të udhëzohen. Vështroji vendtakimet e muslimanëve, vendtakime të pafrytshme dhe të parregullta, ku asnjë bisedë e hajrit nuk del prej tyre. Kërko prej tyre, në radhë të parë, të agjërojnë prej përtacisë, bisedave të*

*pahijshme dhe të kota. Kalo pak nga tregjet dhe pazaret, në të cilat, shpesh, ndodhin grindje, zënka e mashtrime. Eja e ringjall marrëveshjen e imanit, ashtu që muslimanët të ulin nivelin e lakmisë. Hyr në vendbanimet e muslimanëve dhe jepu atyre atmosferën e ramazanit, duke i kujtuar, që të gjithë, për rëndësinë dhe dobinë e edukimit prej shpirtit të Kur’anit fisnik...”*

Ramazani i ngjan pranverës, ashtu sikurse pranvera i jep hijeshi dhe gjallëri natyrës, ashtu edhe muaji i agjërit ngjall jetën e bujshme, me vlera e virtyte, të besimtarit.

Tani është koha që ta gjejmë Allahun dhe të ulemi rreth sofrës së Tij. Kush jeton me Allahun sa është shëndosh e mirë, ai nuk do të brengoset kur një ditë do të takohet me Të. Sa keq për ata që kur do t’u vijë momenti i dorëzimit të shpirtit, do ta dëshirojnë atë që edhe Kur’ani e përshkruan: *“Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, ai thotë: O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që po e lë. Kurrsesi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë të cilën ai (kot) e thotë.”* (El-Mu’minun, 90-100) Apo siç thotë në një sure tjetër: *“Prandaj jepni prej të mirave që u kam dhënë Unë, para se t’i vij vdekja ndonjërit, e të thotë: “O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, e të jepja lëmoshë dhe të bëhesha prej mirëve.”* (El-Munafikunë, 10)

Prandaj, vëllezër e motra, është momenti që ne t’i ndezim shkëndijat e besimit dhe ta përgatisim vetveten për ta pritur sa më këndshëm dhe me plotë dashuri muajin e bekuar të Ramazanit, e t’i themi: Eja e lëshoi rrezet hyjnore në dritaret e hapura të zemrave tona!





Arben Halluni, teolog

## NJË NATË E MADHNUESHME NË RAMAZAN

“**N**e e zbritëm atë (Kur’anin) në Natën e Kadrit. E ç’të bëri ty të dish se ç’është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë Natë) zbresin melekët dhe shpirti (Xhebrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zotit) është paqë deri në agim të mëngjesit.” (El-Kader)

Allahu xh.sh me madhërinë e Tij dhe më dijen e Tij të pakufishme ka ngritur disa krijesa të ndryshme në shkallë më të lartë se të tjerët, qoftë kjo në kohë apo në vende të larmishme. Prej këtyre krijesave lëndore janë edhe njerëzit, të cilët edhe ata kanë dallime dhe ngritje pozicionesh. Pikërisht për këtë thuhet në Kur’an: “Këta janë të dërguarit, disa tyre i dalluam nga të tjerët, prej tyre pati që Allahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë...” (El-Bekare, 253). Sikurse Allahu xh.sh dalloi disa vende nga të tjerat. “(Ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to të përmendet emri i Tij...” (En-Nur, 36). Nga këto vende të dalluara dhe të shenjta janë Mesxhidil-Haram (Qabeja), Medineja e ndritshme dhe xhamia El-Aksa. Gjithashtu ka dallime të disa kohëve nga të tjerat. Do të thotë se prej këtyre kohëve është muaji i madhëruar i Ramazanit. “Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës

së drejtë dhe dallues ( i të vërtetës nga gënjeshtria). (El-Bekare:185). Këtë dallueshmëri muaji i Ramazanit e merr nga një natë e madhnueshme dhe e përhershme e Kadrit. Kjo natë e madhe ishte ndër më të veçantat e jetës profetike të Pejgamberit a.s. Një natë e mbushur plotë nënshtrim, përukje dhe meditim. Në kohën kur i Dërguari i Fundit po kërkonte në shpellën Hira udhëzimin e Krijuesit të tij zbriten ajetet e para kur’anore: “Lexo, me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)...”. (El-Alak,1). Kur Pejgamberi a.s filloi të përgëzonte



te popullin e tij për këtë revelatë hyjnore një pjesë e tyre filluan ta etiketojnë si magjistar, i marrë dhe jo normal. Në këtë situatë zbresin ajete të tjera kuranore nga meleku

Xhibrail, të cilat konfirmojnë të vërtetën se janë fjalë të Allahut xh.sh. “Nun, betohem në pendën dhe në atë çka shkruajnë! Ti, me dhuratën (pejgamber) e Zotit tënd, nuk je i çmendur...” (El-Kalem: 1, 2). Gjithashtu Allahu xh.sh thotë: “Pasha yllin kur ai bie (prej së larti poshtë)! Shoku juaj (Muhamedi që ju e njihni) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar (nga e vërteta). Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet” (En-Nexhm:1-4). Këtë e vërtetë e pamohueshme tregohet në një rivajet (transmetim) të Ibn Abbasit (r.a.) se: “Kur’ani ka zbritur i plotë në Natën e Kadrit në qiellin e dynjasë. Pastaj Allahu xh.sh ia zbriti (në tokë me anë të melekut Xhebrail) pjesë-pjesë”. “Atë e solli shpirti besnik (Xhebraili)” (Esh-Shuara, 193). Po ashtu Allahu xh.sh ka premtuar se këtë libër hyjnor do ta mbrojtë me fuqinë e Tij absolute: “Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur’anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” (El-Hixher, 9). Për bri kësaj sureje Allahu xh.sh zbrat këto ajete: “Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues ( i të vërtetës nga gënjeshtria). Ndërmjet kësaj dhe asaj vjen sureja El-Kader për të përmendur këtë Natë të madhnueshme dhe të vlefshme në shumë aspekte. “Ne e zbritëm atë (Kur’anin) në Natën e Kadrit”. Pra, Allahu xh.sh e zbriti Kur’anin në muajin e Ramazanit dhe në Natën e Kadrit. Nga rëndësia dhe vlera e madhe që ka ajo Pejgamberi a.s, e ka përmendur në një hadith të tij profetik: “Ai që falet (duke e shoqëruar me dua-luje, dhikre, sa-

lavate etj,) në Natën e Kadrit i falen mëkatet e mëparshme”. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Kërkojeni (me luje dhe namaze) Natën e Kadrit në dhjetë ditëshin e fundit të Ramazanit”. Ndërsa, kur është pyetur Aisha (r.a), për lutjen e veçantë të Profetit të Islamit a.s, në natën e Kadrit ajo ka thënë: “O Zot! Ti je Falës dhe Bujar, e do faljen, prandaj më fal mua”.

Zbritja e Kur’anit Famëlartë në këtë Natë të adhnueshme është një sihariq për ata që dojnë me besu dhe vepru sipas asaj që Allahu xh.sh ka zbritur. Besimtari duhet të personifikohet me këtë Libër Hynor nëpërmjet fjalëve të tij të singerta, veprave të spikatura me devotshmëri dhe nënshtrim permanent dhe sjellje të përkryera, sepse Krijuesi i gjithësisë e ka dalluar nga të gjitha krijesat dhe vendosur në një pedestal të lartë. Kur’ani Fisnik duhet të jetë për ne argumenti jetës, udhëzuesi jonë, përfundimi i kësaj jete dhe takimi në botën e amshuar.

Kur’ani famëlartë i cili filloi t’i zbriste Pejgamberit tonë të dashur, Muhamedit a.s. pikërisht në Natën e madhërueshme të Kadrit përbën një vazhdimësi të librave të tjerë të shpallur më përpara përse i përket besimit në një Zot të vetëm. Ai ndryshon nga të tjerët sa i përket disa parimeve, por jo në pikëpamje esenciale.

Kur’ani famëlartë është aktual dhe i përgjithshëm për çdo kohë, vend e situatë, sepse pas Muhamedit a.s. nuk pritet të vijë ndonjë pejgamber tjetër, ngase Ai është vula e mbarë të dërguarve. Kur’ani i shenjtë mbetet libri i fundit i shpallur. Kushdo që pati fatin të shijojë Kur’anin famëlartë si libër i Allahut xh.sh., nuk u nda e nuk do të ndahet kurrë prej tij. Ky Libër i shenjtë bërë heronj, edukojë burra, civilizoi njerëzit dhe gjithë ummetin e Profetit Muhamed a.s.

Njerëzit në përgjithësi dhe sidomos myslimanët i kushtuan një kujdes të

veçantë e të pashembullt Kur’anit, duke u thelluar vazhdimisht në studimin dhe njohjen e thelbit e të fshehtave të tij. Asnjë libër hyjnor a shkencor me përmbajtje morale, etike, shoqërore apo gjuhësore, madje i çfarëdo fushe të dijes qoftë, nuk ua tërhoqi vëmendjen njerëzve dhe as që u studiuua me interesim të madh sa Kur’ani i shenjtë.

Kur’ani famëlartë është udhëzues i mbarë njerëzimit. Me anë të aplikimit të këtij libri të shenjtë gjendet shpëtimi si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër të amshuar, që s’ka dyshim se ka me qenë. Allahu xh.sh. në një ajet Kur’anor thotë: “Me të vërtetë Kur’ani të udhëzon në atë që është më e përsosur dhe besimtarëve të cilët bëjnë vepra të mira, u jep sihariqin, për ta do të ketë shpërbllim të madh”. Allahu xh.sh. është Ai që në Kur’an udhëzon e mëshiron besimtarët. Nisur nga të gjithë kjo madhështi që ka Kur’ani, besimtarëve u del për detyrë që ta aplikojnë me përgjegjësi çdo gërmë të tij dhe larg qoftë të jenë si çifutët që patën librin hyjnor, Teuratin, që e lexuan dhe kuptuan se çka kishte në brendësi të tij, por nuk iu përmbajtën. Kështu ata nuk patën kurrfarë dobie prej leximit të Librit... Ja si e përshkruan ajeti i 5 i sures El-Xhumua shembullin e tyre: “Shembulli i atyre, që janë obliguar me Tëvrat dhe nuk e zbatojnë atë, është si ai shembulli i ndonjë gomari që bart libra. Shembulli i keq, është shembulli i popullit që përgënjeshtroi ajetet e Allahut, e Allahu nuk udhëzon në rrugë të drejtë popullin jobesimtar”.

Pra, ne jemi ummeti i Kur’anit. Krenaria e këtij ummeti është në Librin e tij Hyjnor. Është ky Libër Famëlartë që bashkoi të gjithë muslimanët. Ai është kushtetuta e dy botëve, shpirtërore dhe lëndore. Është shpirti që ngjall të vdekurit, rizgjon zemrat dhe shëron mëkatet e njerëzve. Është nur, dritë që ndriçon rrugën e



të udhëzuarve. “O ju njerëz, juve ju erdhi nga Zoti juaj argumenti dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë” (En-Nisa, 174).

Atëherë, nëse nata e Kadrit është nata që Allahu na ka nderuar me zbritjen e Kur’anit është detyrë e muslimanëve që të pasurohen shpirtërisht për çdo fjalë lutjeje me të cilën i drejtohen Allahut xh.sh.

Transemtuar nga Aisha r.a. thotë se “Kur hynte dhjetëditëshi i fundit i Ramazanit i Dërguari i Allahut ishte më aktiv në adhurim dhe lutje gjatë netëve dhe pikërisht për këtë, ai zgjonte edhe familjen e tij për t’iu bashkuar mirësive të natës së Kadrit”.

Po në këtë kontekst Pejgamberi a.s ka thënë: “Ju erdhi muaji i Ramazanit, në të është një Natë më e mira se një mijë muaj. Kush nuk përfiton nga ajo (Natë) nuk përfiton asnjë të mirë. Nuk përfiton asnjë të mirë vetëm mospërfituesit”...

Allahu qoftë iu kënaqur me lutjet dhe adhurimet tona në këtë Natë të madhnueshme!

Amin!

Shkodër, më 20.06.2014





**Naim Drijaj**

imam, xhamia Parrucë

**N**ëse Allahu xh.sh. na ofron mundësinë që ta mbërrijmë muajin e Ramazanit, duhet ta dimë se ky është një shans për ne, një mundësi e re, një ofertë nga ana e Allahut xh.sh. që të na falen gjynahet dhe që të fitojmë sa më shumë sevape.

Ashtu sikur se gjethet që lëshojnë pemët, lulet që lulëzojnë dhe farat që hidhen në pranverë për të dhuruar fruta të shumëfishta, ashtu edhe ky muaj i bekuar është pranvera e zemrave dhe e shpirtave të besimtarëve. Pejgamberi a.s. ka thënë: Sa i pafat është njeriu që e arrin muajin e Ramazanit, i kalon ditët e tij dhe pasi të përfundojë muaji i ramazanit, Zoti nuk i ka falur asnjë nga gjynahet e tij.

Ramazani shoqërohet me edukimin dhe përmirsimin e besimtarëve.

Transmetohet se sahabet janë pas lutur gjashtë muaj para Ramazanit që ta mbërrijnë këtë muaj të bekuar, ndërsa gjashtë muajt që pason pas Ramazanit janë lutur nga Allahu që Ai t'ua pranojë agjërimet e muajit të Ramazanit. **(Sahihu Nesai)**

Në prag të ramazanit, i dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, mbante një fjalim ku u thoshte njerëzve: “O njerëz, është duke ardhur për ju një muaj i bekuar, një muaj në të cilin ndodhet një natë që është më e mirë se sa njëmijë muaj.”

I Dërguari i Allahut thoshte: “Erdhi muaji i Ramazanit. Ai është muaji i bekimit të Allahut. Allahu në të ju ruan, lëshon mbi ju rahmetin e Tij,

## NË FRYMËN E RAMAZANIT...

ju falë gjynahet dhe ua pranon dua-të. Allahu u sheh se si bëni gara me njëri-tjetrin se kush kryen vepra më të mira gjatë këtij muaji dhe mburret me ju përpara melekve. Jepni gjithçka nga vetja që Allahu t'ju shoh vetëm mirë. Me të vërtetë është i pafat ai që mbetet jashtë mëshirës së Allahut në këtë muaj!” **(Tabaraniu).**

Në Ramazan duhet bërë kujdes rreth disa gjërave kryesore, që janë përmendur në porositë e Pejgamberit (a.s.):

1. Pendesa dhe përmendja e Allahut.
2. Distancimi dhe ruajtja nga gjërat



e ndaluara dhe të shëmtuara.

3. Dhënia iftar një agjëruesi.

4. Kryerja e shumë të mirave sipas mundësive. Fitimi i bekimit dhe i lutjes së njerëzve zemërthyer, të dëshpëruar dhe nevojtarë.

5. Distancimi nga bisedat dhe polemikat e panevojshme në shtëpi. Krijoni atmosferë qetësie dhe prehjeje në shtëpitë tuaja duke kryer veprime me të cilat Allahu i Lartësuar është i kënaqur.

6. Ringjalleni shpirtin, mendjen dhe trupin me agjërim. Agjëroni me shpirtin duke e këshilluar atë për

jetën e shkurtër, me mendjen duke e mbajtur larg nga epshet dhe me trupin duke e përmbajtur dhe duke e kontrolluar nga ushqimet dhe pijet.

7. Kontrolloni gjuhën dhe përmbajeni veten nga fjalët e tepërta. Mendojini ato që thoni.

Allahu xh.sh. thotë: “Nuk ka fjalë që njeriu e nxjerr nga goja dhe atë fjalë mos ta regjistrojë një vëzhgues që i qëndron pranë.” **(Kaf, 18)**

Allahu i Lartësuar na ka dhuruar dy sy dhe dy veshë, por vetëm një gjuhë, prandaj duhet më shumë të dëgjojmë dhe sa më pak të flasim.

Ramazani është muaji i cili u komunikon muslimanëve bashkimin dhe unifikimin e tyre.

Muaji i ramazanit është muaji i mëshirës dhe i faljes së gjynaheve dhe gabimeve, muaji i begatisë dhe i bamirësisë, muaji i shpëtimit nga zjarri i xhehnemit, muaji i leximit të Kur'anit, muaji i agjërimit, muaji i përkujdesjes ndaj prindërve dhe i interesimit për farefisnin.

Allahu e ka caktuar këtë muaj kohë për adhurim dhe për garë se kush bën më shumë punë të mira gjatë tij. Duhet të lutemi sa më shpesh dhe të shpenzojmë sa më shumë që të mundemi për bamirësi. Duhet ta lexojmë sa më shumë Kuranin famëlartë, të ndihmojmë të varfrit, nevojtarët dhe jetimët.

Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e agjëron muajin e Ramazanit, duke qenë i bindur në besimin islam dhe duke shpresuar (shpërblim nga Allahu xh.sh), do t'i falen gabimet që ka bërë deri në atë muaj.” **(Buhari, Muslim)**

Nga Enes ibn Maliku transmetohet se kur fillonte muaji Rexheb, Pejgamberi a.s. thoshte: “O Zot, bëji të begatë për ne muajt Rexheb dhe Shaban, na e bëj të mundur ta mbërrijmë muajin Ramazan!” **(Ahmedi, Tabaraniu)**

## AKTIVITET NË NDERIM TË HAFIZ SABRI KOÇIT



**P**araditën e sotme, në xhaminë e Rusit u zhvillua një aktivitet përkujtimor në nderim të personalitetit të Hafiz Sabri Koçit, Kryetarit të parë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, pas viteve 1990.

Në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës, vlerësoi simbolikën që përfaqëson personaliteti i H. Sabri Koçit, si trashëgimtar i një plejade të nderuar të Hoxhallarëve të shkuar të Shkodrës, prej të cilëve mësoi dhe u edukua, si dhe modelin e qëndresës së besimit para mosbesimit dhe terrorit afetar, që pllakoi Shqipërinë për dekada!

Myftiu kërkoi që rruga kryesore e Rusit musliman të ketë emrin e Hafiz Sabri Koçit, në kujtim dhe respekt të tij. Në këtë kontekst, Myftiu theksoi se e ka dorëzuar kërkesën e tij në Këshillin e Bashkisë Shkodër, madje e ka prsëritur disa herë, por paradoksisht nuk ka marrë akoma përgjigje.

Njëkohësisht bëri thirrje që organet vendore të bëjnë punën e tyre për

lirimin e truallit të kësaj xhamie, të zaptuar nga tetë familje të pastreha, në mënyrë që të mundësohet ndërtimi i xhamisë së Rusit, për të cilën propozoi që të ketë emrin "Xhamia Hafiz Sabri Koçi".

Imami i xhamisë, H. Fejzi Zaganjori, mbajti një referat të zgjeruar mbi jetën dhe veprimtarinë e Hafiz Sabri Koçit, duke vlerësuar rolin e tij në rimëkëmbjen e Thirrjes Islame pas viteve '90, si dhe kontributet e tij në afrimin e Shqipërisë me botën islame. Imami i nderuar, përmendi edhe disa nga bashkëpunëtorët më të afërt të Hafiz Sabri Koçit, me të cilët nisi punën për të ngritur nga hiçi, komunitetin më të madh fetar në vend.

Aktiviteti u pasua nga përshëndetja e familjarëve, këndimi i një ilahie të bukur nga mbesa e Hafizit rahmetli, vajza e talentuar Selma Bektishi, si dhe dua-hatmeja për shpirt të Hafiz Sabri Koçit.





## XHAMIA E PARRUCËS ME TAPET TË RI NË PRAG TË RAMAZANIT 1435

**D**itën e mërkurë, më 18 qershor 2014, pas namazit të iqindisë, nisi puna për ndërrimin e tapetit të xhamisë së Parrucës, pas nevojës së madhe që kishte kjo xhami për një tapet të ri.

Falë Zotit, ky tapet erdhi si dhuratë për xhaminë e Parrucës nga familja e të nderuarit, Haxhi Besnik Elbasani, të cilët patën mirësinë t'i përgjigjen kësaj nevojë të xhamisë dhe besimtarëve të saj.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër shpreh mirënjohjen dhe vlerësimet e saj më të mira për këtë familje dhe

bamirësinë e tyre, në shërbim të komunitetit të besimtarëve frekuentues të kësaj xhamie, vizitorëve të saj të shumtë dhe vetë xhamisë së Parrucës.

Pas shtrimit të xhamisë, pritet të përfundojë edhe faza e lyerjes së plotë të minareve dhe krejt objektit të xhamisë Parrucë dhe më pas, me mbarësinë e All-llahut, ditën e xhuma, më 27 qershor 2014, do të bëhet edhe inaugurimi i këtyre punimeve dhe tapetit të ri në xhaminë e Parrucës, në prag të Ramazanit të sivjetshëm, që nis me 28 qershor 2014.



## IMAMËT, TAKIM NË PRAG TË RAMAZANIT

**D**itën e martë, më 24 qershor 2014, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka zhvilluar një takim udhëzues, me imamët e Shkodrës, në prag të Ramazanit 1435/2014, që nis ditën e shtunë, më 28 qershor 2014

Fillimisht, Myftiu ka uruar imamët me rastin e Muajit të begatë, duke theksuar se Ramazani, nuk është thjeshtë një muaj i zakonit, por një stinë e Thirrjes Islame, për të cilën, - e kemi për detyrë të punojmë me krejt forcat dhe mundësitë që kemi!

Më pas, Myftiu ka dhënë udhëzi-

met e tij në lidhje me mbarëvajtjen e anës teknike që lidhet me xhaminë dhe jetën e saj gjatë këtij muaj, si: respektimi maksimal i orareve të imsakut dhe akshamit, falja e 20 rekateve të lehta të teravisë, në respekt edhe të orarit të vonë veror, përhapja e hartës së xhamive, ku do të këndohet Hatmeja e plotë e Kur'anit, si: Parrucë, Perash, Tophanë, Rus, "Ebu Bekër", Medrese etj.

Myftiu ka ftuar imamët që të angazhohen me sa kanë mundësi, që besimtarët të kalojnë një Ramazan sa më të begatë, në paqe me Zotin, veten, tjetrin.





## “SOFRA E KUR’ANIT”, AKTIVITETI I PËRVITSHËM NË PRAG TË RAMAZANIT

**P**asditën e së mërkurës, më 25 qershor 2014, Myftinia Shkodër ka organizuar për të katërtin vit radhazi, aktivitetin fetar, në prag të Muajit të Begatë të Ramazanit: “Sofra e Kur’anit”.

Këtë vit, për herë të parë, ky aktivitet u zhvillua në teatrin “Migjeni”, ku të pranishëm për të kënduar pjesë të ndryshme nga Kur’ani, Libri i fundit hyjnor, i zbritur në Muajin Ramazan, ishin, hafizët e nderuar: Abdullah Shaqiri (Maqedoni), Idriz Osmani (Maqedoni), Ali Pollat (Gjermani), Ibrahim Akbullut (Gjermani) dhe Ahmed Hillmaz (Danimarkë).

Aktiviteti u përshëndet nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, që falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë mbrëmje të mbushur me emocionet dhe përshtetësinë e prag-Ramazanit.

Myftiu theksoi se Kur’ani është garancia më e mirë për jetën e njerëzimit, për t’u kthyer nga besimi dhe vërtetësitë e tij shekullore absolute, të përmbledhura në Kur’anin Famëlartë, të vetmin Libër hyjnor



të padevijuar nga dora e njeriut.

Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, në fjalën e tij përshëndetëse, uroi të gjithë besimtarët me rastin e Muajit Ramazan, duke falënderuar këtë organizim, në të cilin mbushen zemrat me Fjalën e Zotit dhe lartësohet Emri i Tij.

I ftuar special i kësaj mbrëmje të begatë besimi në Shkodër, ishte

edhe drejtori i Thirrjes Islame në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, teologu Elvis Naçi.

Në ligjëratën e mbajtur prej tij, u spikat ftesa për t’u kthyer nga Kur’ani, si Libri në të cilin, secili njeri mundet të gjejë rrugët e suksesit dhe mbarësisë në jetë. Nëpërmjet shembujve realë nga jeta e përditshme dhe tregimet e të parëve, teologu Elvis Naçi bëri thirrje që besimtarët të jenë të kujdesshëm në respektimin e porosive kur’anore dhe urdhëresave hyjnore, që e edukojnë njeriun të jetë shembull udhëzimi në jetën e tij.

Të pranishmit ndoqën me shumë kënaqësi edhe këndimet e pjesëve të ndryshme kur’anore dhe ilahitë e bukura në gjuhën shqipe, që mbushën sallën me emocionet e besimit dhe ato të Muajit Ramazan.

Për të pranishmit, Myftinia Shkodër ka shpërndarë edhe broshurën: “Njinimi i Muajit Ramazan”, nga Hoxha i nderuar, H. Vehbi S. Gavocçi, si dhe kalendarin e këtij muaji të begatë.





**Imam Muhamed B. Sytari**  
Myfti i Zonës Shkodër

## FALEMINDERIT, TË NDERUAR VËLLEZËR BAJRAMI!

**M**brëmjen e xhumasë, më 20 qershor 2014, u gëzo-va pa masë, teksa merrja pjesë në ceremoninë e inaugurimit të xhamisë së re "Riza Bajrami" dhe Qendrës Sociale "Nënë Ilmije", në Shkozet të Durrësit.

Donatorët e kësaj vepre madhore, Vëllezërit Bajrami, i dhuruan djembarë shqiptarëve një shembull të gjallë, që të mbush syrin dhe zemrën me bukurinë dhe madhështinë e tij! Ishte shembulli i faktit se natyrshmëria e Islamit i tërheq me thjeshtësinë dhe butësinë e saj zemrat e singërta, me pastërtinë e të bukurës, drejt vendosjes së vullnetit të besimit në shinat e shërbimit ndaj komunitetit, pa ndrojtjen e paragjykimit, në një kohë kur është bërë e modës të hidhet baltë mbi identitetin dhe vo-

kacionin shpirtëror të muslimanëve shqiptarë!

Në një farë mënyre, bukuria dhe drita e këtij Kompleksi Islam, sfidoi në heshtje neverinë e përbaltjes mediative të viteve të fundit dhe imponimin e heshtur, tinzar dhe abuzues me elementin fetar dhe historinë e origjinave fetare tek shqiptarët!?

Qe mrekullisht bukur dhe pastër, edhe pa prezencën e shumëkujt, që në inaugurime të ngjashme, i shohim të rendin në rresht për një, për të zënë vendet e para dhe ekranet e televizioneve a faqeve të gazetave, si njerëz të përkushtuar ndaj "thirrjes së Zotit", a "forcës së besimit"! Mjerisht për ta, humbën inaugurimin e xhamisë së parë shqiptare me katër minare, pak kilometra larg kryeqytetit shqiptar, që në mjerimin e 24 viteve të fundit, pret në heshtje një "Sadeka Nderi" nga ndonjë dorë e pastër dhe e fisme, për të "firmosur" vendimin historik të pajisjes me xhaminë e shumëpritur katedrale të muslimanëve shqiptarë!?

Ndoshta, në heshtjen e tyre, këto katër minare të bardha, sikur na dhanë të gjithëve, që jemi mësuar të kapërdijmë neglizhencën a mospërfshirjen në merakun e mosndërtimit të një xhamie katedrale në kryeqytet, me heshtjen e imponuar a bisedat vrastare të vullneteve, nëpër kafenetë e provincializmit intelektual e shpirtëror; një mësim të qetë e të heshtur!

Kur edhe ngurtësirat të japin mësim me heshtjen e tyre, do të thotë se është koha për të bërë një kontroll të hollësishëm a një "rezonancë magnetike", për të nxjerrë në pah diagnostikimin e sëmundjeve të akumuluar nga 16 nëntori 1990 e deri më sot!?

Mirëpo a ka pajisje që e bën këtë vizitë? Dhe, mbi të gjitha, a është kush në gjendje të lexojë rezultatin e pritshëm, që më pas të japë edhe recetën e shërimit?!

Natyrshëm, ne nuk jemi këta që dukemi, nëse shpresojmë të dësh-mohemi ata që duhet të jemi!

Qe realisht, një mbrëmje e bekuar, prej atyre që të bën të ndjehesh krenar për shumëçka dhe, për pak momente, të harron dhembjen e 24 viteve të humbura..., ndonëse dhembjen e tyre nuk e shëron asgjë, përveç inaugurimit të Xhamisë Katedrale, në zemër të kryeqytetit të vendit më musliman në Evropën e vlerave!

Faleminderit, të nderuar Vëllezër Bajrami!

*Shkodër, më 21 qershor 2014*





المسجد الإسلامي الشكودري  
دار الإفتاء - مدينة شكوذرة  
KOMUNITETI MUSLIMAN I SHKODËR  
MYFTINIA SHKODËR

# MYFTINIA SHKODËR JU URON: ME ZEMËR TË MIRË RAMAZANIN!

## RRUGËTIMI MË I MIRË ME RAMAZANIN ËSHTË PASTRIMI I ZEMRËS NGA URREJTJA, MLEFI DHE GJYNAHET, QË E PENGOJNË PËR TË SHIJUAR KËNAQËSINË E ADHURMIT

*Agjëro edhe ti..!*

### KALENDARI I RAMAZANIT 1435/2014

DITË	Qendra	Ramazan	Shehri	Lindja e ditës	Dëska	Iqritja	Yllin	Teravix
	Korrik		(Shkollë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)
E shkollë	26	1	02-58	05:07	12:53	16:53	20:27	22:21
E ditë	29	2	02-58	05:07	12:53	16:53	20:27	22:21
E shkollë	30	3	02-59	05:08	12:53	16:52	20:27	22:21
E shkollë	1	4	03-00	05:09	12:54	16:52	20:27	22:20
E shkollë	2	5	03-01	05:09	12:54	16:52	20:27	22:20
E shkollë	3	6	03-01	05:09	12:54	16:52	20:26	22:20
E shkollë	4	7	03-02	05:10	12:54	16:52	20:26	22:19
E shkollë	5	8	03-03	05:10	12:54	16:52	20:26	22:19
E ditë	8	9	03-04	05:11	12:54	16:52	20:26	22:18
E shkollë	7	10	03-06	05:11	12:55	16:53	20:26	22:17

DITË	Korrik	Ramazan	Shehri	Lindja e ditës	Dëska	Iqritja	Yllin	Teravix
			(Shkollë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)
E shkollë	8	11	03-06	05:12	12:56	16:53	20:26	22:17
E shkollë	9	12	03-07	05:12	12:55	16:53	20:26	22:14
E shkollë	10	13	03-09	05:12	12:55	16:53	20:24	22:15
E shkollë	11	14	03-10	05:14	12:55	16:53	20:24	22:14
E shkollë	12	15	03-11	05:15	12:55	16:53	20:23	22:13
E ditë	13	16	03-12	05:16	12:55	16:53	20:23	22:13
E shkollë	14	17	03-13	05:16	12:56	16:53	20:22	22:12
E shkollë	15	18	03-15	05:17	12:56	16:53	20:22	22:11
E shkollë	16	19	03-16	05:18	12:56	16:53	20:21	22:09
E shkollë	17	20	03-17	05:19	12:56	16:52	20:21	22:08

DITË	Korrik	Ramazan	Shehri	Lindja e ditës	Dëska	Iqritja	Yllin	Teravix
			(Shkollë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)	(Orë)
E shkollë	18	21	03-19	05:20	12:56	16:52	20:20	22:07
E shkollë	19	22	03-20	05:20	12:56	16:52	20:19	22:06
E ditë	20	23	03-22	05:21	12:56	16:52	20:19	22:05
E shkollë	21	24	03-23	05:22	12:56	16:52	20:18	22:04
E shkollë	22	25	03-26	05:23	12:56	16:52	20:17	22:03
E shkollë	23	26	03-26	05:24	12:56	16:52	20:16	22:02
E shkollë	24	27	03-27	05:25	12:56	16:51	20:16	22:00
E shkollë	25	28	03-29	05:26	12:56	16:51	20:14	21:58
E shkollë	26	29	03-31	05:27	12:56	16:51	20:14	21:57
E ditë	27	30	03-32	05:28	12:56	16:51	20:13	21:56

23.07.2014 (e mërkurë) - Natë e Kadrit | 29.07.2014 (e hënë) - Ditë e parë e Fitër Bajramit | Bajrami tërë në orën 06:25  
Folje e Sabahut bëhet 20 minuta pas Imsakit (Sylvitit) | Ora e parë e reftaraz zëmbës së Shkodrës

**Botues:**  
Myftinia Shkodër  
Drejtues:  
Imam Muhamed Sytari

**Dizajn & Grafik:**  
Bledar Xama

**Tel / Fax:**  
+355 (0) 224 2081  
**Nr. llogarie:**  
100054 UBA - Shkodër

**E-mail:**  
udhaislame@myftinia-shkoder.org  
**Website:**  
www.myftinia-shkoder.org